

○ Informacion i pergjithshem

❖ **Organizimi**

Shoqeria ” **Mulliri i Vjeter**” sh.p.k eshte krijuar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901dt.14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

❖ **Objekti dhe Kontributet**

Shoqeria ” **Mulliri i Vjeter** ” sh.p.k ka si objekt Aktivitet te përpunim dhe tregtimit me shumice dhe pakice te kafese dhe nenprodukteve te saj etj. Kontributi ne shoqeri eshte per shumen 134.000.000 leke dhe perbehet nga kontributi ne kapital i ortakeve:

- Z. **Lulëzim Huqi i cili zoteron** një kuote, me vlerën nominale **67,000,000 leke**, ose 50% te kapitalit.
- Z. **Melisa Huqi e cili zoteron** një kuote, me vlerën nominale **67,000,000 leke**, ose 50% te kapitalit..

❖ **Administrimi**

Shoqeria drejtohet nga administratori i vetem i shoqerise z. **Lulëzim Huqi**, dhe eshte rregjistruar ne organin tatimor te qytetit Tirane me NIPT K72417027E.

○ Permbledhje e politikave kontabel

❖ Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin 9228 dt.29.04.2004 ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera sipas “Parimit te drejtave te kostatuara”. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë). Veprimet jane hedhur ne menyre kronologjike dhe te kompjuterizuar ne programin “FINANCA 5”. Veprimet jane ngurtesuar me 31.12.2018.

Shifrat e paraqitura ne pasqyrat financiare te vitit 2018, jane te krahasueshme me ato te vitit 2017, pasi nuk ka ndryshime ne politikat kontabile.

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2018 eshte zbatuar formati i SKK-2

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, ne hartimin e pasqyrave financiare te vitit 2018, janë si më poshtë:

- **Vijimesia** e veprimtarise ekonomike e subjektit eshte e siguruar, pasi nuk ka ne plan nderprerjen e aktivitetit te tij ekonomik.
- **Kompensimi** midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave she shpenzimeve ka vetem kur lejohen nga SKK.

Shenime per Deklarimet Financiare Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

- **Kuptueshmeria** e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote, per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem, qe kane njohuri te pergjitheshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
- **Materialiteti** eshte vleresuar nga ana jone, dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
- **Besueshmeria** per hartimin e pasqyrave financiare eshte e siguruar, pasi nuk ka gabime materiale, duke zbatuar parimet e meposhteme:

-Parimin e paraqitjes me besnikeri.

-Parimin e perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen.

-Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem.

-Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nenvleresim dhe mbivleresim te qellimshem.

-Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te Pasqyrave Financiare.

-Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat kontabel.

-Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

❖ **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, mbeshtetur ne dokumentacionin justifikues. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Shpenzimet e periudhes ushtrimore jane te krahasueshme dhe te lidhura me te ardhurat e te njejtës periudhe.

❖ **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos fillestare te amortizuar dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2018 jane 1 euro=123.42 leke, 1 dollar= 107.82 leke.

❖ **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin raportues, bazohet mbi fitimin e tatuueshem, i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2018 eshte 15 %

❖ **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohesh në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar

Shenime per Deklarimet Financiare Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre nominale të amortizuar. (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

❖ Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre nominale të amortizuar neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

❖ Aktivet Afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës se mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qendrueshme. Normat e përdorura janë sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” në ndertesa 5 % të vlerës se mbetur, për pajisjet informatike 25 % të vlerës se mbetur dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës se mbetur.

❖ Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje të inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi.

Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve, vlerësuar sipas metodës së koston mesatare të ponderuar.

○ Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve të bilancit

Çelja e vitit 2018 rakordon me mbylljen e vitit 2017. Për vitin 2018 shumat e kolonës “Ushtrim i Mbyllur” si në aktiv dhe në pasiv kapin shumën **543.921.122** leke .

I. Aktivët Afatshkurter

Aktivët afatshkurterë në pasqyrat financiare të vitit 2018 paraqiten sipas zerave me poshte:

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

1. **Mjetet monetare** ne arke dhe banke me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018 jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Para ne dore	5,462,244	77,139,109
Para ne Banka	73,122,040	5,841,634
Totali	<u>78,584,284</u>	<u>82,980,743</u>

Gjendjet e llogarive te likujditeteve ta paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes, dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventareve fizike te monedhave. Tepricat e llogarive ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te dates 31.12.2018 te Bankes se Shqiperise, 1 euro=123.42 leke, 1 usd=107.82 leke.

3.(i).**Te drejta te arkëtueshme** perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018, deklarohen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Kliente	<u>26,189,503</u>	<u>24,926,893</u>
Totali	<u>26,189,503</u>	<u>24,926,893</u>

Ne llogarine “Te drejta te arketueshme” jane pasqyruar faturat e papaguara te shitjes se produkteve dhe mallrave qe shoqeria ka realizuar gjate vitit ushtrimor 2018.

3.(iv).**Te tjera te drejta te arketueshme** perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018, deklarohen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Paradhenie per punonjesit	0	20,000
Tatim mbi fitimin	14,633	193,828
Llogari dogane	851,711	352,727
Te tjera garanci	24,130	-
Garanci Akcize	478,232	242,999
Blokim fondi per blerje objekti	692,500	692,500
Totali	<u>2,061,206</u>	<u>1,502,054</u>

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

4. Iventaret perfaqesojne gjendjen e iventareve ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor si me poshte

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Mallra	13,159,904	15,141,943
Inventar I imet	6,121,826	8,515,035
Lende te para	48,639,018	58,002,919
Produkte të Gatshme	5,188,653	4,494,874
Ambalazh	23,847,112	13,970,028
Paradhenje per furnizime	12,486,465	9,694,020
Totali	<u>109,442,978</u>	<u>109,818,819</u>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit, dhe me inventarin fizik te kryer ne fund te ushtrimit. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrje-daljet e inventarit, jane tranzituar ne llogarite e rezultatit, me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit , eshte perdorur metoda e kosos “mesatare te ponderuar

5. Shpenzime te shtyra ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shpenzime te periudhave te ardhshme	3,430,539	4,257,192
Totali	<u>3,430,539</u>	<u>4,257,192</u>

Shpenzime te shtyra perfaqeson ,Shumen e shpenzimeve te riparimit te sjelljes ne kushte optimale dhe mirembajtjes se objekteve te mara me qera por qe nuk do te konsumohen te tera gjate ketij viti ushtrimor.

II Aktivet afatgjata

2. Aktivet Afatgjata materiale (AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale per vitin ushtrimor 2018, ne pasqyrat financiare paraqiten si me poshte:

	Toka+Ndertime	Mak.pajisj+mj.tr	Te tjera	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>				
Gjendje 01.01.2018	139,040,763	152,565,194	54,508,890	346,114,847
Shtesa	47,696,842	37,146,817	18,775,349	103,619,008

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

Pakesime		2,830,419	887,780	3,718,199
Gjendje 31.12.2018	186,737,605	186,881,592	72,396,459	446,015,656

<i>Amortizimi</i>				
Gjendje ne 01.01.2018	14,683,648	70,455,697	23,191,895	108,331,240
Shtesa llogaritur	2,429,617	18,219,690	7,156,291	27,805,599
Pakesime	0	768,813	0	768,813
Gjendje ne 31.12.2018	17,113,265	87,906,574	30,348,186	135,368,026

<i>Vlera neto 01.01.2018</i>	124,357,115	82,109,497	31,316,995	237,783,607
<i>Vlera neto 31.12.2018</i>	169,624,339	98,975,018	42,048,273	310,647,630

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i aktiveve afatgjata materiale (AAM-ve), te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme, jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike, qe shoqeria ka kryer ne fund te muajit Dhjetor 2018. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes, dhe ne daten e mbylljes se bilancit, me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve, dhe per rrjedhoje nuk ka llogaritur zhvleresime. Metodatat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura nga shoqeria, jane te njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.

2. (iv). Aktivet Afatgjata materiale (AAM-te) ne proces

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Parapagime për aktive materiale dhe në proces	13,564,980	0
Totali	<u>13,564,980</u>	<u>0</u>

I. Detyrimet afatshkurtera

I.a “*Detyrimet afatshkurtera*” ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018 paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Arkëtime në avancë për porosi	111,650	100,000
Furnitore	12,010,180	12,855,387
Te pagueshme ndaj punonj.dhe sig.shoqerore	3,560,078	3,108,675

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

Të pagueshme për detyrimet tatimore	6,307,278	6,079,867
Te tjera ne pritje	24,130	35,294
Totali	22,013,316	22,179,223

“Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per shumen 12,010,180 leke, per blerjen e mallrave dhe te sherbimeve, te cilat jane te palikujduara ne fund te vitit ushtrimor, dhe do te likujdohen ne 12 muajt e ardhshem. Kjo llogari eshte e azhornuar dhe shuma e llogarive analitike, te mbajtura per cdo furnitor, eshte e barabarte me llogarine sintetike. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane vleresuar realisht.

Detyrimet per “Te pagueshme ndaj punonj.dhe sig.shoqerore” jane perfshire detyrimet e shoqerise per sigurimet shoqerore te muajit Dhjetor 2018, qe do te likujdohen ne muajin janar 2019.

Zeri "Arketime ne avance per porosi" ne vleren 111,650 leke perfaqeson fature paradhenie bere klientit.

Zera “Te tjera ne pritje “perfaqeson garanci deri ne perfundim te kontrates .

I.(ix) “Detyrimet tatimore”, te analizuara sipas zerave, ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor, paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
TVSH	5,390,874	5,279,451
Tatim ne burim	916,404	800,416
Totali	6,307,278	6,079,867

“Të pagueshme për detyrimet tatimore”, per shumen 6,307,413 leke perfaqeson detyrimet tatimore per TVSH-ne dhe Tatimin e mbajtur ne burim, qe do te likujdohen ne fillim te vitit 2019.

II Detyrimet Afatgjata

II.(ii). “Huate afatgjata”, te analizuara sipas zerave, ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor, paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Huate afatgjata	81,267,077	67,307,153
Totali	81,267,077	67,307,153

Huate afatgjata perfaqesojne kredi afatgjate dhe kontrata qeraje (Leasing) te marra prane Societe General Bank.

III. Kapitallet e veta

Kapitallet e veta te shoqerise per vitin ushtrimor 2018, paraqiten sipas tabelës me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Katitali I nenshkruar	134,000,000	134,000,000
Rezerva ligjore	13,400,000	12,450,433
Rezerva statutore	2,780,637	0
Rezerva te tjera	221,602,295	150,728,418
Fitimi/Humbja e vitit	68,857,796	74,604,082
Totali	<u>440,640,729</u>	<u>371,782,933</u>

“Kapitali aksioner” i shoqerise i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise, dhe te depozituar ne QKB. Kapitali gjate vitit 2018 ka pesuar rritje. Gjate vitit 2018 zerat ne kapital kane pesuar ndryshime bazuar ne vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise. Fitimi i vitit 2017 ka kaluar ne zerin “Rezerva Statutore” ne vleren 2,780,637 leke, ne zerin “Rezerva ligjore” ne vleren 949,567 dhe diferenca prej 70,873,878 leke ne zerin “Rezerva per Investime” sipas vendimit te ortakeve per perdorimin e Fitimit te vitit 2017. Ndryshimi I posteve te ndryshme te kapitalit, ne menyre dinamike paraqiten ne pasqyren perkatese te “Kapitaleve te veta”, ndersa Fitimi (Humbja) e vitit financiar paraqitet ne “Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve”.

❖ **Fitimi (humbja) e vitit financiar**

- **Te ardhurat** e realizuara gjate periudhes ushtrimore 2018, paraqiten sipas zerave te tabelës me poshte:

1. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shitje mallrash	74,688,316	78,075,733
Shitje e produkteve te gatshem	682,853,224	653,468,279
Ndryshimi në inv. e prod. të gattshme	693,780	1,702,890
Totali	<u>758,235,320</u>	<u>733,246,901</u>

4. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Te ardhura nga kontrata	1,150,753	-
Te ardhura nga shitja e AAM-ve	4,151,078	-
Te ardhura nga demshperblimet	47,500	-
Te ardhura nga ekzekutimi i proc. Gjyq.	-	243,001
Te ardhura shuarja e det. ndaj furnitorit	325,791	197,768
Totali	<u>5,675,122</u>	<u>440,769</u>

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

Te ardhurat e raportuara ne bilanc kane diference me ato te Sistemit informatik tatimor te deklaruar ne FDP-ne e Tvsh-se si rezultat I ketyre zerave me poshte.

	Deklarata per Tatim Fitimin viti 2018	Qarkullimi i TVSH-se viti 2018
Shitje mallrash	75,038,307	75,038,307
Shitje e produkteve te gatshem	682,123,843	682,123,843
Shitje materiale dhe furnitura	729,382	729,382
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme	693,780	-
Te ardhura nga Shitja e AAM	4,151,078	4,151,078
Te ardhura nga shuarja e detyrimit ndaj furnitorit	325,791	-
Te ardhura nga kontrata	1,150,753	1,150,753
Zbritje te akorduara klienteve, brenda vendit	(330,000)	(330,000)
Zbritje te akorduara klienteve, ne eksport	(19,990)	
Te ardhura nga demshperblimet	47,500	
Fitim nga kembime valutore monetare	1,802,496	-
Te ardhura nga interesat	13,814	-
Totali	765,726,752	762,863,364
Diferenca	2,863,389	

○ **Shpenzimet**

Shpenzimet e realizuara si konsumi I materialeve, mallrave, shpenzimet e tjera nga veprimtaria e shfrytezimit, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme sipas dokumentacionit baze, faturave tatimore. Shpenzimet e personelit jane pasqyruar sakte si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2018, jane pasqyruar ne pasqyren perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimet e analizuara sipas zerave paraqiten si me poshte:

5. **Shpenzimet per “Mallrat, lendet e para dhe sherbimet” sipas zerave, paraqiten si vijon:**

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Materiale te para	350,637,571	363,404,647
Energji elektrike,uje	13,223,115	11,749,405
Shpenzime te tjera materiale	7,960,569	7,351,142
Totali	371,821,255	382,505,194

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

9. “Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit” sipas zerave analitike, paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Qira	61,348,341	48,436,347
qera makine	2,075,441	3,197,138
Kanceleri	450,483	1,010,719
Mirembajtje dhe riparime	14,732,523	11,841,924
Taksa rregjistrimi	0	64,214
Te tjera	8,821,860	5,784,641
Personel nga jashte ndermarjes	1,969,908	2,086,720
Publicitet, reklama	4,771,699	2,631,457
Shpz.postare e telekom.	1,681,111	1,465,610
Transporte per blerje	0	3,154,777
Transporte per shitje	32,895	52,138
Sherbime bankare	675,517	671,108
Sherbime doganore	171,357	0
Tatime te tjera/Taksa vendore	6,845,615	6,353,368
Shpenzime per personelin	1,326,801	168,983
Shpenzime per pritje dhe perfaq.	0	977,950
Gjoha dhe demshperblime	2,020,181	392,797
Shpenzime te tjera	7,628,513	8,360,532
Shpenzime per sponsorizime	1,407,400	133,380
Komision disbursim kredie	101,343	122,995
Sigurime	1,751,620	1,069,602
Vlera kontabel e AAM te shitura	2,949,840	0
Dieta	2,313,111	680,202
Dieta tej normave	3,676,806	6,308,673
Bileta udhetimi	2,401,180	3,037,922
Zbritje te akorduara klienteve	0	118,226
Totali	<u>129,153,546</u>	<u>108,121,423</u>

6.” Shpezimet per personelin“ paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Paga	124,739,366	108,079,262
Sigurime shoqerore	16,327,650	14,003,140
Totali	<u>141,067,016</u>	<u>122,082,402</u>

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

✓ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**“ paraqiten si me poshte:

13.1. “Te ardhurat dhe shpenzimet per interesat” ne fund dhe ne fillim te periudhes ushtrimore paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Te ardhura nga interesat	13,814	12,166
Shpenzime nga interesat	-2,285,101	-1,814,932
Totali	-2,271,288	-1,802,766

13.2. “Te ardhurat dhe shpenzimet financiare” ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore paraqiten si vijon

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Fitim nga kembime valutore monetare	1,802,496	1,411,212
Humbje nga kembimet valut. monetare	-1,968,591	-26,290
Totali	-166,095	1,384,922

Te ardhurat dhe shpenzimet per kembimet valutore, jane paraqitur ne pasqyrat financiare te vitit ushtrimor per diference, sipas kerkesave te SNK Nr.12. Te ardhurat dhe shpenzimet ngainteretat jane paraqitur gjithashtu per diference sipas kerkesave te standardeve, dhe perfaqesojne interesat e paguara per kredite e marra.

✓ **Fitimi neto**

Shpenzimet per tatimin mbi fitimin, dhe fitimi neto i shoqerise per periudhen ushtrimore, paraqitet si vijon:

16. Fitimi (Humbja) e vitit financiar

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Fitim Bruto	85,503,819	90,516,841
<u>Shpenzime te pa njohura</u>	25,469,664	15,568,222
a. Gjoha, penalitete, dem.	2,020,181	392,797
b. Shpenzime te tjera	11,611,281	8,360,531
c. Komision dis. kredi Range	311,965	122,995
d. Dieta extra	3,676,806	6,308,673
e. Shpenzime per personelin	1,326,801	168,983
f. Sigurime per Range Velar	-	214,243
g. Shp. interesa per autoveture	195,551	-
h. Shp. Amort. per Autovetura	3,848,070	-

Pasqyrat Financiare 2018 “MULLIRI I VJETER” Sh.P.K. Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2018

i.Shp.per skonto viti 2017	2,479,008	-
Baza llogaritjes Tatimit	110,973,484	106,085,063
% e tatim Fitimit	15	15
Tatim Fitimi	16,646,023	15,912,759
Fitimi Neto	68,857,797	74,604,082

Tatimi mbi fitimin e ushtrimit eshte llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar me shpenzimet e panjohura, sipas legjislacionit fiskal.

❖ *Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit*

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se hartimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin e vitit 2018 eshte rritur shifra e afarizmit..

Financiere

Esmeralda SHEHI

ADMINISTRATORI

Lulezim HUQI